



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

SENATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë, Tel +383 (0) 29- 232 140, Homepage www.uni-prizren.com

Nr. i ref. \_\_\_\_\_

Prizren, më: 07.02.2022

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 42 dhe 47 paragrafi 1.3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" me nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, Senati i Universitetit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 07.02.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen një zëri propozimet e Njësive Akademike në Universitetin "Ukshin Hoti" për angazhimin e personelit akademik për semestrin Veror të vitit akademik 2021/2022, si më poshtë:
  - Fakulteti Juridik
  - Fakulteti i Ekonomisë
  - Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
- II. Propozimi i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetit të Filologjisë kthehen për rishqyrtim nga Komisioni Vlerësues.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më datë: 07.02.2022 ka shqyrtuar propozimet e njësive akademike për angazhimin e personelit akademik për semestrin Veror të vitit akademik 2021/2022. Pas shqyrtimit të propozimeve Senati vendosi që t'i miratoj propozimet e Fakultetit Juridik, Fakultetit të Ekonomisë dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, ndërsa propozimet e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetit të Filologjisë kthehen për rishqyrtim në Komisionin Vlerësues.

Andaj, bazuar në nenin 42 dhe 47 paragrafi 1.3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 7 ditësh nga momenti i publikimit në webfaqe, në Komisionin e Ankesave si instancë e fundit në nivel të Universitetit.

Të njoftohen:

1. Menaxhmenti i UPz-së;
2. Sekretari i Përgjithshëm;
3. Nj. Akademike;
4. Arkivi.

Kryesuesi i Senatit  
*Prof. Asoc. Dr. Samir Krasniqi*  
  
